

RAPORTI I PERFORMANCËS

Albanian Development Guarantee Foundation (ADGF)

Viti 2024



Përmbajtja

1. OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET	3
2. ARRITJET DHE PERFORMANCA	4
3. RAPORTIMI FINANCIAR	5
4. STRUKTURA, DREJTIMI DHE RAPORTIMI.....	7
Aneksi 1: Lista e Shkurtimeve	9



1. OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Ky raport është përgatitur në përputhje me nenin nr. 22 (3) të Ligjit 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, të ndryshuar, ku organizatave jofitimprurëse në Shqipëri u kërkohet të përgatisin dhe publikojnë, së bashku me pasqyrat e tyre vjetore financiare, një raport të performancës. Ky raport përgatitet nga ato organizata jofitimprurëse që në pasqyrat e tyre financiare, shuma e aktiveve ose të ardhurave tejkalon vlerën 30 milion Lekë. Albanian Development Guarantee Foundation e plotëson këtë kusht. Qëllimi kryesor i raportit të performancës është të sigurojë që një organizatë jofitimprurëse t'i përgjigjet publikisht palëve të interesuara në paraqitjen e performancës së saj.

Albanian Development Guarantee Foundation (“ADGF” dhe “Fondacioni”) u themelua sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë. Fondacioni njihet më parë si Fondacioni Rural Credit Guarantee (“RCGF”), i krijuar me Vendimin e Gjykatës nr. 518, datë 08 korrik 2015 dhe ndryshimi i emrit u miratua nga gjykata më 06 dhjetor 2021. Ndryshimi i emrit erdhi në kuadër të zgjerimit të fushës së mbulimit për aktivitetet e garantuara për të qenë në përputhje me misionin dhe vizionin e fondacionit.

Ideja për themelimin e fondacionit u konceptua si pjesë e kornizës IPA të BE-së, për të financuar një program “Programi për Garancinë e Kredisë Rurale” në Shqipëri me qëllim rritjen e të ardhurave familjare në zonat rurale të Shqipërisë. Aktivitetet u bashkëfinancuan nga BE dhe Qeveria e Shqipërisë për një vlerë totale prej 5.5 milion Euro, nga të cilat 5 milion Euro ishin nga BE (3.57 milion Euro u transferuan në ADGF për kapitalizimin e fondacionit dhe 1.43 milion Euro u përdorën për shërbime konsulence për themelimin e fondacionit) dhe 0.5 milion Euro ishin nga Qeveria e Shqipërisë për të mbuluar shpenzimet operative. Projekti fillestar, nga nëntori 2014 deri në mars 2016, u zbatua nga Banka për Zhvillim KfW.

Kapitali i fondacionit është rritur me shtesat prej 29.35 milion Euro në dhjetor të vitit 2018; 6.76 milion Euro në dhjetor të vitit 2020 dhe 5.4 milion Euro në dhjetor të vitit 2021 nga Qeveria Gjermane nëpërmjet Bankës për Zhvillim KfW, e cila vazhdon të mbështesë Fondacionin përmes ndihmës dhe konsulencës teknike.

Misioni i ADGF është të sigurojë qasje në financim, me qëllim zgjerimin e shërbimeve financiare në një segment pak të shërbyer të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në të gjithë sektorët e të ekonomisë, për shkak të mungesës ose pamjaftueshmërisë së kolateralit, për t’iu mundësuar atyre të mbijetojnë ose rimarrin disa aftësi të humbura, duke rezultuar në mbajtjen, krijimin ose rikrijimin e vendeve të punës.

ADGF përmbush misionin e saj përmes një mekanizmi garancie të ndarjes së rrezikut për:

- a) kredi bankare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme dhe
- b) kredi komerciale për institucionet financiare jobanka me qëllim kreditimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në sektorë të ndryshëm të ekonomisë (kryesisht në zonat rurale).

Objektivi i Fondacionit është të inkurajojë bankat dhe institucionet financiare jobanka të ofrojnë shërbime financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në sektorë të ndryshëm ekonomikë, mbi baza të qendrueshme, për tu mundësuar krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen dhe konkurrueshmërinë në treg.

ADGF është një fondacion që operon në mënyrë direkte dhe të pavarur në Shqipëri, nuk ka filiale dhe nuk është i lidhur me asnjë fondacion tjetër.

2. ARRITJET DHE PERFORMANCA

Më 31 dhjetor 2024, është vlerësuar se, ADGF përmes instrumentit të saj të garancisë, ka mbështetur më shumë se rreth 25,703 ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme, për një total prej 168.2 milion Euro (vlera e akumuluar e kredive që prej fillimit të aktivitetit, nga të cilat 73.8 milion Euro ishin për institucionet financiare jobanka), duke rezultuar në afro 21,071 vende të reja pune dhe 34,070 punë të mbajtura siç paraqiten në tabelën nr.1 më poshtë. Llogaritjet janë realizuar nga ADGF bazuar në të dhënat e raportuara nga institucionet financiare partnere (banka dhe institucione financiare jobanka).

Numri i punëve		
Punë të krijuara	Banka	6294
	Institucione mikrofinanciare jobanka	14777
	Totali	21071
Punë të mbajtura	Banka	9441
	Institucione mikrofinanciare jobanka	24629
	Totali	34070

*Tabela nr.1: Vlerësimi i punëve të krijuara dhe punëve të mbajtura prej fillimit të aktivitetit të garancisë
Burimi: Llogaritje të ADGF*

ADGF nuk është e kufizuar në ndonjë zonë gjeografike ose aktivitet biznesi në Shqipëri, për sa kohë që këto sektorë nuk janë në listën e përjashtimeve. Për më tepër, ka edhe limitime të kredive siç janë të parashikuara në marrëveshjet e financimit me secilin institucion financiar partner.

ADGF ofron garanci nëpërmjet disa dritareve. Dritarja e Rregullt është dritarja më e madhe e garancisë e cila është aktive që prej themelimit.

Pas saj, në dhjetor 2018 u hap Dritarja e Gjelbërt, me një fond total prej 2.65 milion Euro të marra nga KfW. Kjo dritare fokusohet në energjinë e rinovueshme dhe në efikasitetin e energjisë duke ofruar mbështetje për investimet e bizneseve që çojnë në ulje të konsumit të energjisë ose të emetimeve të CO² prej të paktën 20% mesatarisht. Fondi total u përdor i gjithi deri në fund të vitit 2024, por ADGF do vazhdojë ta ketë këtë dritare aktive edhe në vazhdim duke rialokuar një fond prej 3 milion Euro nga kapitali ekzistues.

Në prill 2020, ADGF krijoi një dritare të veçantë (dritarja Covid) për të mbështetur kompanitë e prekura nga pandemia Covid-19, fillimisht me 10 milion Euro të rialokuara nga kapitali ekzistues dhe më pas me 6.76 milion Euro të marra nga KfW. Qëllimi i kësaj dritareje ishte rigjallërimi ekonomik dhe ruajtja e punësimit për bizneset. Dritarja ishte e përkohshme dhe u mbyll në fund të vitit 2022, ndërsa fondet u transferuan në Dritaren e Rregullt në fillim të vitit 2023.

Në maj 2021, ADGF rialokoi 3 milion Euro nga kapitali bazë për hapjen e një dritareje të veçantë dedikuar bizneseve të reja (dritarja start-up). Gjithashtu, ADGF mori një fond prej 5.4 milion Euro në dhjetor 2021 nga KfW ekskluzivisht për dritaren e bizneseve të reja. Qëllimi i dritares është përmirësimi i aksesit në financa për bizneset e regjistruara së fundmi në mënyrë që të kontribuojë në promovimin e rritjes dhe punësimit në Shqipëri.



3. RAPORTIMI FINANCIAR

Në fund të vitit 2015, ADGF mori 3.57 milion Euro nga BE. Këto fonde u transferuan nga KfW në ADGF, bazuar në marrëveshjen financiare që ADGF dhe KfW kishin nënshkruar për veprimtarinë e garancisë.

Më tej, gjatë vitit 2015 dhe 2016, ADGF mori një grant prej 0.5 milion Euro nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural sipas Programit IPA 2012. Qëllimi i këtij granti ishte të kompensojë Fondacionin për shpenzimet operative të bëra.

Gjatë vitit 2018, KfW dhe ADGF nënshkruan një marrëveshje për një financim të ri deri në shumën 5 milion Euro, të ndarë në 2 këste prej 4.35 milion Euro dhe 0.65 milion Euro. Marrëveshja u nënshkrua në 12 Shtator 2018. Më vonë, gjatë këtij viti, më 5 Dhjetor 2018, KfW dhe ADGF nënshkruan një marrëveshje të re për një financim të ri, në shumën 25 milion Euro. Ndërsa në 20 dhjetor 2018 u disbursua kësti i parë i marrëveshjes së parë, dhe të gjitha fondet nga marrëveshja e dytë. Shuma totale e marrë në 2018 është 29.35 milion Euro. Qëllimi i këtij kontributi financiar ishte rritja e kapitalit të ADGF të përdorur për lëshimin e garancive në dobi të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në Dritaren e Rregullt dhe Dritaren e Gjellbër.

Gjatë vitit 2020, KfW dhe ADGF nënshkruan një marrëveshje për një financim në shumën 6.76 milion Euro, për të rritur kapitalin e garancive të ADGF në përgjigje të pandemisë së Covid-19.

Gjatë vitit 2021, KfW dhe ADGF nënshkruan një marrëveshje tjetër për një financim të ri në shumën totale prej 6 milion Euro, i ndarë në 2 këste: kësti i parë prej 5.4 milion Euro (për rritjen e kapitalit të garancisë së ADGF për bizneset e regjistruara së fundmi) dhe kësti i dytë, prej 0.6 milion Euro (për asistencë teknike për institucionet partnere dhe bizneset e reja). Kësti i parë prej 5.4 milion Euro u mor në dhjetor 2021 nën Dritaren e bizneseve të reja (start-up).

Këto fonde përdoren për të dhënë garanci për klientët nëpërmjet institucioneve bankare në baza të ndarjes së riskut dhe me limit maksimal deri në 500,000 Euro dhe gjithashtu garanton huamarrjet tregtare të institucioneve mikrofinanciare nga bankat lokale nën garanci të veçanta

Më 31 dhjetor 2024 garancitë e dhëna janë si më poshtë:

	<i>Vlera e mbetur e garantuar (Lekë)</i>	<i>Vlera e disbursuar e garantuar (Lekë)</i>
Garanci për NOA	688,601,156	2,017,857,812
Garanci për FedInvest	650,359,000	1,258,048,739
Garanci për Fondi Besa	835,062,815	2,078,091,942
Garanci për CFFA	74,313,630	134,956,275
Garanci për Agro Social Fund	178,421,360	308,049,223
Garanci për klientët e Credins Bank	227,903,414	776,374,127
Garanci për klientët e BKT	126,424,690	370,261,748
Garanci për klientët e Union Bank	1,114,095,433	2,492,181,418
Garanci për klientët e Fibank	72,364,377	158,571,729
Garanci për klientët e OTP Bank	547,337,700	1,400,243,725
Garanci për klientët e ISP Bank	100,193,176	131,017,491
Garanci për klientët e Procredit Bank	26,728,223	27,102,250
Totali në Lekë	4,641,804,975	11,152,756,477



Vlera e mbetur e garantuar tregon vlerën e mbetur të garancive të dhëna nga Fondacioni. Vlera e disbursuar e garantuar tregon vlerën e garantuar të huave të disbursuara, që është 50%-70% e vlerës totale të disbursuar për klientët e bankave dhe 75%-100% e vlerave të disbursuara për institucionet mikrofinanciare.

Fondacioni ka investuar fondet e kapitalit në letrat me vlerë (bono thesari, obligacione, eurobonde) të lëshuara nga Qeveria Shqiptare dhe këto investime përdoren si kolateral për kontratat e garancisë financiare që u janë dhënë bankave dhe institucioneve financiare jobanka.

ADGF vazhdimisht kërkon institucione të reja partnere për të arritur misionin e saj. Më 31 dhjetor 2024, bankat dhe institucione financiare jobanka partnere të ADGF janë si më poshtë:

Banka:

- 1) Banka Kombëtare Tregtare (BKT)
- 2) Credins Bank
- 3) Union Bank
- 4) First Investment Bank (FiBank)
- 5) OTP Bank
- 6) Raiffeisen Bank
- 7) Intesa San Paolo Bank
- 8) Procredit Bank

Institucione Financiare jobanka:

- 1) NOA
- 2) Fedinvest
- 3) Fondi BESA
- 4) Crimson Finance Fund Albania (CFFA)
- 5) Agro & Social Fund (ASF)

Fondacioni funksionin në bazë të parimit të vijimësisë, i cili supozon se Fondacioni do të vazhdojë të operojë në të ardhmen e parashikueshme, mbështetur në objektivin e lëshimit të garancive financiare. Bazuar në buxhetin e aprovuar, Fondacioni planifikon të rrisë aktivitetin e tij operacional dhe parashikon rezultate pozitive në vitin në vijim.

4. STRUKTURA, DREJTIMI DHE RAPORTIMI

Albanian Development Guarantee Foundation është një fondacion i regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, njohur si 'ADGF', me NIPT L52004452B, me Vendim Gjykatë për themelimin e Fondacionit nr. 518, datë 08 korrik 2015, me adresë në rrugën 'Abdi Toptani', Torre Drin, kati 9, Nr. 93, 1001, Tirana, Albania.

ADGF drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv i cili reporton në Bordin e Drejtorëve. Bordi i Drejtorëve është niveli më i lartë i qeverisjes, me 3 anëtarë, respektivisht Zj. Bahrije Dibra si përfaqësuese e Bankës për Zhvillim KfW, Z. Martin Mici si përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe Z. John Khoury, i cili aktualisht drejton Bordin, është nominuar nga KfW dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Struktura organizative e ADGF është paraqitur në figurën nr.1 më poshtë:




Figura nr. 1. Struktura organizative e ADGF

Sipas statutit të fondacionit, Drejtori Ekzekutiv mund të angazhojë me kontratë Fondacionin për një vlerë deri në 500.000 Euro (ose ekuivalentin përkatës në lekë). Kontratat e garancisë financiare me vlerë që tejkalojnë shumën prej 500.000 Euro i nënshtrohen aprovimit paraprak të Bordit të Drejtorëve.

Donatorët e ADGF janë: KfW, Bashkimi European dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Një nga objektivat e KfW si një bankë zhvillimi dhe e BE-së, si një bashkim ekonomik dhe politik unik, është të sigurojë fonde për qeveritë, ndërmarrjet publike dhe bankat tregtare të angazhuara në mikrofinancë dhe promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vendet në zhvillim për të ndihmuar ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të mbijetojnë ose të rimarrin disa kapacitete të humbura, duke mbajtur dhe krijuar vende pune. Ky objektiv përbën njëkohësisht misionin dhe qëllimin e ADGF.



Ky raport i Fondacionit më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024, u përgatit nga Drejtimi i Albanian Development Guarantee Foundation në 24 prill 2025, dhe u aprovua nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve të ADGF:

Përgatitur nga:


Z. Bajram Korsita
Drejtör Ekzekutiv

Datë: 24 prill 2025

Aprovuar nga:


Z. John P. Khoury
Kryetar i Bordit të Drejtorëve

Datë: 24 prill 2025





Aneksi 1: Lista e Shkurtimeve

ADGF – Albanian Development Guarantee Foundation

ASF – Agro Social Fund

BE – Bashkimi European

BKT – Banka Kombëtare Tregtare

CFFA – Crimson Finance Fund Albania

IPA - Instrument for Pre-Accession Assistance

KfW - Kreditanstalt für Wiederaufbau

RCGF - Rural Credit Guarantee Foundation

SME – Small Medium Enterprises (Ndërmarrje të vogla, të mesme)